

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK
Dep.	01-2684/14
Dep.	18-07-2014
Nr. Ifaq.	
Broj stranica	
Nr. pages	02
Date	
Datum	
Dati	
SHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (parografi 1.1), nenit 5 (parografi 1 pika 1.5), nenit 18 (parografi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, si dhe nenit 19 (parografi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 16.07.2014, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbylljet rasti me nr. AKK-03-3281/13, për z. Ekrem Hoxha, Kryetar i Bordit në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihaqet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Ekrem Hoxha, Kryetar i Bordit në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Hoxha është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, për të cilin është dyshuar se ushtron dy funksione të papajtueshme, si Kryetar i Bordit në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe si person i autorizuar në biznesin privat Kosova Enterprise Development Consulting Agency.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korruptionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimit të kësaj shkresë, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast ai është bindur me fakte për

situatën në të cilën ndodhet si dhe ndryshimet të cilat duhet ti bëj, për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Hoxha ka deklaruar se biznesi është pasiv dhe nuk është funksional, ka ndodhur ndonjë gabim në regjistrim si biznes individual në Agjensinë e Regjistrimit të Bizneseve, ngase po i njëjti biznes është shuar si Sh.P.K. Kosova Enterprise Development Consulting Agency.

Prandaj zyrtari i lartë z. Hoxha ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, për të bërë ndryshimet e nevojshme në Agjensinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, për të shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Duke parë se procesi i ndryshimeve po zgjatë Agjencia i ka bërë shkresën e dytë sipas procedurës ligjore që quhet “njoftimi paralajmérues”, me të cilin zyrtarit të lartë i është bërë e qartë se duhet të shmanget situata e konfliktit të interesit brenda afatit të caktuar, përndryshe do të pasojnë masat tjera sanksionuese të parapara me ligj

Ndërkohë, përfaqësuesi i autorizuar nga zyrtari i lartë z. Hoxha ka dërguar në Agjenci shkresen zyrtare të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03- 2623/14) në të cilën vërtetohet se ka bërë shuarjen vullnetare të biznesit privat.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligiit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

